



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KURBIN  
KËSHILLI BASHKIAK KURBIN

Nr. 3411/12 prot.

Laç, më. 26.07.2023

VENDIM

Nr.15 datë 21.07.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.104 DATË 21.12.2022 "PËR MIRATIMIN E PAGËS SË PUNONJËSVE TË BASHKISË KURBIN, NJËSIVE DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI PËR VITIN 2023" SI DHE NË VKB NR.106 DATË 21.12.2022 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2023 DHE NUMRIN TOTAL TË PUNONJËSVE"**

Bazuar në ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 54 pika (ç), në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.604, datë 14.09.2022 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Vendimin nr.113, datë 1.3.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", të Këshillit të Ministrave, si dhe në VKB nr.104, datë 21.12.2022 "Për Miratimin e pagës së punonjësve të Bashkisë Kurbin, Njësive dhe Institucioneve në Varësi për vitin 2023", pas propozimit nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës 14.06.2023, pas propozimit nga Kryetarja e Bashkisë dhe nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës 21.07.2023;

**VENDOSI:**

1. Të miratojë këto ndryshime në numrin e punonjësve të Bashkisë Kurbin, Njësive dhe Institucioneve në varësi:
  - Tek *Kabineti i Kryetarit*, të shtohen 2 (dy) pozicione pune me emërtesën "Këshilltar Ekonomik" dhe "Këshilltar i Çështjeve Sociale".
  - Pagat e pozicionit të jenë 58000 (pesëdhjetë e tetë mijë) lekë.  
Kabineti i Kryetarit ishte me 4 (katër), punonjës të bëhet me 6 (gjashtë), punonjës.
  - Tek *Drejtoria për Koordinimin e Integritimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj*, të shtohet 1 (një) pozicion pune me emërtesën "Specialist për Emigracionin dhe Diasporën".
  - Paga e pozicionit të jetë 32000 (tridhjetë e dy mijë) lekë.  
Drejtoria për Koordinimin e Integritimit Evropian dhe Ndihmës së Huaj ishte me 4 (katër), punonjës të bëhet me 5 (pesë), punonjës.
  - Tek *Drejtoria e Financës, "Sektori i zhvillimit ekonomik të aseteve dhe statistikave"*, të shtohet 1 (një) pozicion pune me emërtesën "Specialist (Ekonomist)".
  - Paga e pozicionit të jetë 32000 (tridhjetë e dy mijë) lekë.

➤ Tek "Njësia Administrative Milot" pozicioni punës "Specialist Veteriner dhe Specialist i Protokoll Arshivës", të ndahet në pozicionin e punës "Specialist Veteriner", me pagë pozicioni 40000 (dyzet mijë), lekë dhe në pozicionin e punës "Sekretar i Protokoll Arshivës", me pagë pozicioni 40000 (dyzet mijë) lekë.

Njësia Administrative Milot ishte me 19 (nëntëmbëdhjetë), punonjës të bëhet me 20 (njëzet punonjës).

➤ Tek "Njësia Administrative Fushë-Kuqe" pozicioni punës "Inspektor për Emergjencat Civile dhe Specialist i Protokoll Arshivës", të ndahet në pozicionin e punës "Inspektor për Emergjencat Civile", me pagë pozicioni 40000 (dyzet mijë), lekë dhe në pozicionin e punës "Sekretar i Protokoll Arshivës", me pagë pozicioni 40000 (dyzet mijë) lekë.

Njësia Administrative Fushë-Kuqe ishte me 15 (pesëmbëdhjetë), punonjës të bëhet me 16 (gjashtëmbëdhjetë), punonjës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi brenda 10 (dhjetë), ditëve.

**Prefektit të Qarkut Lezhë**  
**Drejtoria e Burimeve Njerëzore**  
**Drejtoria e Financës**  
**Arkivi**

**SEKRETARI I KËSHILLIT**  
**Arber LEKA**



**KRYETARE E KËSHILLIT**  
**Edlira LLESHI**

